



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2415 datë 04.02.2014

Për
“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelcom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Iris Khanaj, në mbledhjen e datës 04.02.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Vlerësimin e pozites dominante në tregjet përkatëse të sipërmarrësit Albtelcom Sh.a., mbi baëzn e Dokumentit “Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë:segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar” si dhe vendosjen e masave rregulluese”.

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Grupi i Punës, të përbërë nga:

- i. Relacioni shpjegues;
- ii. Dokumenti “Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë:segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar”;
- iii. Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

- 1) Shkronja ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
- 2) Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
- 3) Ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike;
- 4) “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, ndryshuar me vendimin nr. 2342, datë 31.07.2013, të Këshillit Drejtues të AKEP (Rregullorja);
- 5) Vendim Nr. 2340 datë 31.07.2013, Për “Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk – Këshillim Publik”;
- 6) Vendim Nr. 2414 datë 04.02.2014, Për “Miratimin e Dokumentit: “Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar”;

KËSHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Dokumenti “Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar” reflekton punën e Grupit të Punës si dhe komentet dhe vërejtjet e bëra gjatë mbledhjes.
2. Dokumenti “Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar”,
 - a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 01.08.2013-29.09.2013, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 2, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
 - b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - c. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kritereve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;

- d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
- e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.

ATËHERE:

Për sa më sipër, mbi bazën e vlerësimit të pozitës në tregjet përkatëse të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., sipas Dokumentit “Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar”, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I :

1. Bazuar në dokumentin “Analizë e tregut të Linjave me Qira: tregjet me pakicë: seti minimum dhe tregjet me shumicë: segmentet terminuese dhe trunk - Dokumenti Përfundimtar”; miratuar me VKD Nr.2414 datë 04.02.2014, të përcaktojë sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., sipërmarrës me FNT në *Tregun përkatës me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira, pavarësisht teknologjisë së përdorur për ofrimin e kapaciteteve me qira apo të dedikuara.*
2. Dimensioni gjeografik i tregut përkatës me FNT është kombëtar apo territori i Republikës së Shqipërisë dhe dimensionin e plotë i produktit/shërbimit është sipas përcaktimeve të Dokumentit të Analizës së Tregut të miratuar me VKD Nr. 2414 datë 04.02.2014
3. Sipërmarrësi ALBTELECOM sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:

3.1 Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9918

3.2 Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. 9918

3.3 Detyrimi për ndarjen e llogarive, sipas nenit 41 të ligjit nr. 9918.

3.4 Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918.

3.5 Detyrimin për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9918.

4. Detyrimet e mësipërme në pikën 3, përfshijnë midis të tjerave:

4.1. *Detyrimi i Mosdiskriminimit:*

- Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a., të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t’u ofrojë sipërmarrësve

të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij;

- Publikimin e Ofertës Referencë të aksesit në rrjetin Albtelecom për segmentet terminuese të linjave me qira me shumicë, brënda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Për këtë pikë Albtelecom do të duhet të zbatojë procedurat dhe rregullat për publikimin dhe përmbajtjen e Ofertës Referencë që janë parashikuar në Ligj dhe në rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit. Oferta Referencë, duhet të përmbajë të gjithë termat dhe kushtet e aksesit në rrjet, përfshirë ato të shërbimeve ndihmëse, termat dhe kushtet kryesore kontraktuale;
- Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a., të publikojë (si pjesë të Ofertës Referencë) Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesorë të Performancës (Key Performance Indicators -KPI) për linjat me qira sipas përcaktimeve të Rregullores së Akses dhe Interkoneksionit. Marrëveshja e nivelit të shërbimit duhet të mbulojë të gjitha aspektet e rëndësishme të ofrimit të linjave me qira me shumicë si kërkesa, porositjen, migrimin, dorëzimin, cilësinë, raportimin, koha e rregullimit të defekteve, dhe kompensime financiare në rast të mos-realizimit të treguesve të rënë dakort.

4.2. *Detyrimi i transparencës:*

4.2.1 Oferta Referencë e Aksesit të Albtelecom për segmentet terminuese të linjave me qira me shumicë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshëm për akses/interkoneksion në linjat me qira të Albtelecom:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikat e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- ç) Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

4.3. *Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashket i faciliteteve të rrjetit:*

4.3.1 Sipërmarrësi Albtelecom Sh.a., për shërbimin e ofrimit të segmenteve terminuese të linjave me qira me shumicë në rrjetin Albtelecom, duhet:

- a) *t'u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij për segmentet terminuese të linjave me qira me shumicë;*
- ç) *të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;*
- d) *të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollat ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve të linjave me qira;*
- f) *të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit për lidhjen e segmenteve terminuese të linjave me qira të Albtelecom me rrjetet e operatoreve të tjerë.*

Detyrimet për akses në linjat me qira tradicionale përfshirë Ethernet në rrjet tradicional të jenë të përkohëshme deri në përfundim të fazës tranzitore të bashkëzistencës së dy rrjeteve dhe sipas mundësive teknike të Albtelecom.

4.3.2 Albtelecom sh.a. duhet të japë akses për segmentet terminuese të linjave me qira me shumicë në rrjetin e vet, duke përfshirë:

- Linja me qira me shumicë (end-to-end): linja të njëjta si linjat e ofruara klientëve fundore;
- Qarqe të pjesshme me qira (Leased line partial Circuits): qarqe transmetimi që lidhin një klient fundor të operatorit tjetër me pikën e interkoneksionit të Albtelecom me operatorin tjetër si dhe qarqet e transmetimit të ofruar nga Albtelecom operatorëve të tjerë për tu përdorur në interkoneksionin e ndërmjetem apo në anën e klientit.
- Kapaciteti i linjave të dhëna nga Albtelecom do të jetë në varesi të kërkesës së blerësit, duke përfshirë dhe qarqet 34 Mbit/s dhe 155 Mbit/s. Rastet e pamundësisë teknike të ofrimit nga Albtelecom, do të duhet të justifikohen me shpjegime të plota, bazuar në rregullat dhe procedurat e kuadrit ligjor dhe rregullator (Rregullorja e Akses dhe Interkoneksion);
- Linja me qira me shumicë mbi Ethernet në rrjet tradicional dhe/ose NGN;
- Akses në linja me qira për lidhje të nyjes së agregimit të linjave lidhëse të MSAN-ve me MSAN-n ku ndodhet Pika fundore e rrjetit (NTU), si shërbim ndihmës për operatorin që kërkon akses në MSAN për LLU.

Për shërbimet e aksesit në Ethernet në rrjetin NGN, Albtelecom duhet të përditesojë ofertën referencë të aksesit në cdo rast të ofrimit të shërbimeve me pakicë të kapaciteteve të dedikuara apo me qira, për të mundësuar ofrimin e inputeve ekuivalente për operatorët e tjerë me shumicë, në mënyrë që këta operatorë të kenë mundësi ofrimit e shërbimeve që ofron Albtelecom me pakicë.

4.4. **Detyrimi për ndarjen e llogarive dhe detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive:**

- Tarifat e shërbimeve të segmenteve terminuese të linjave me qira me shumicë të Albtelecom, janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
- Në përputhje me nenin 57, pika 1 gërma a):
 - Tarifat maksimale të shërbimeve të linjave me qira, që duhet të aplikojë Albtelecom për segmentet terminuese në rrjet tradicional fiks mbi TDM (SDH/PDH), të jenë sipas vlerave në tabelën e mëposhtme:

Shërbimi	Tarifa (LEK)	Njësia
Pagesa mujore për Linjat me qira me shumicë		Paguhet çdo muaj
Linja me qira 2Mbit/s	13 735 lekë + 890 lekë/km	Çmimi fiks për linjë me qira + cmimi për km
Linja me qira 34Mbit/s	250.000 lekë+7.500	Çmimi fiks për linjë me qira + cmimi për km

Adresa: Rr. "Abdi Toptani",
Godina Torre Drini, K. IX, Tiranë

Tel : ++ 355 4 2259 571
Fax : ++ 355 4 2259 106

www.akep.al
info@akep.al

	lekë/km	
Linja me qira 155Mbit/s	500.000 lekë+15.000 lekë/km	Çmimi fiks për linjë me qira + cmimi për km
Pagesa instalimi për Linjat me qira me shumicë		Paguhet vetëm një herë
Instalimi i segmentit të terminimit për linjat me qira (për lidhje deri 2 Mbit/s)	4,905	[për linjë me qira]
Instalimi për linjat me qira (për lidhje 34 Mbit/s)	385.000	[për linjë me qira]
Instalimi për linjat me qira (për lidhje 155 Mbit/s)	430.000	[për linjë me qira]

Tarifat e mësipërme nuk përfshijnë TVSH.

- Tarifat maksimale për kapacitetet me qira mbi Ethernet në rrjet tradicional dhe Ethernet në NGN duhet:
 - o Të mos jenë më të larta se tarifat e tabelës së mësipërme;
 - o Të jenë të pakten 20% më të ulëta se tarifat e shërbimeve respektive me pakicë.
- iii) Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 42 dhe 45) nga Albtelecom, të kryhet në bazë të përcaktimeve të Rregullores “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri”, miratuar me Vendim të KD të AKEP Nr. 2406, datë 26.12.2013.

4.5 Albtelecom në ofrimin e segmenteve terminuese të linjave me qira me shumicë ka detyrimin që të zbatojë afate kohore maksimale të plotësimit të kërkesave, sipas afateve të dhëna më poshtë:

1. për linjat me qira të pastrukturuara (unstructured) **2 Mbit/s: 45** ditë kalendarike
2. për linjat me qira të strukturuara (structured) **2 Mbit/s: 50** dite kalendarike
3. për linjat me qira të pastrukturuara (unstructured) **34 Mbit/s: 60** ditë kalendarike

Afati i ofrimit është koha e sigurimit të linjës me qira nga operatori, nga data kur është bërë një kërkesë e precize (firm request) nga përdoruesi.

4.6 Sipërmarrësi Albtelecom ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të përcaktuara nga AKEP, sipas nevojave të tregut, për statusin e FNT në tregun përkatës të referuar në këtë vendim.

5. Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT në tregun përkatës të referuar në këtë vendim për sipërmarrësin Albtelecom sh.a., është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e Analizës së Tregut të kryer sipas nenit 34 të Ligjit 9918.
6. Në përputhje me nenin 34 të ligjit 9918 dhe pikën 5 të nenit 3 të Rregullores për Analizën e Tregut:

6.1 Detyrimet e sipërmarrësit Albetelcom sh.a. për ofrimin e linjave me qira në tregun me pakicë si dhe në ofrimin e segmenteve kryesore (trunk) të linjave me qira me

shumice, përcaktuar në vendimin nr.1364, date 13.04.2011, të Këshillit Drejtues të AKEP, hiqen.

6.2 Heqja e detyrimeve të cituar në pikën 6.1 me siper bëhet efektive 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Dokumenti “*Analizë e Tregut të Linjave me Qira: Tregu me pakicë i Linjave me Qira dhe tregjet me shumicë të segmenteve terminuese dhe trunk të Linjave me Qira, Dokumenti Përfundimtar*”, i bashkëngjitet këtij vendimi si Aneks 1 dhe është pjesë e tij.
8. Vendimi nr.1364, date 13.04.2011 i Keshillit Drejtues të AKEP shfuqizohet.
9. Kundra këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) diteve pas marrjes së njoftimit përkatës.
10. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Alketa MUKAVELATI**
3. **Benon PALOKA**
4. **Zamira NURÇE**



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**ANALIZË
E
TREGUT
TË LINJAVE ME QIRA**

- 1) Tregu me pakicë i minimumit të linjave me qira (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qira deri në dhe përfshirë 2Mbit/s);
- 2) Tregu me shumicë i segmenteve terminuese të linjave me qira;
- 3) Tregu me shumicë i linjave kryesore (trunk) të linjave me qira;

PËRFUNDIMTARE

SHKURT 2014

(MIRATUAR ME VKD NR. 2414 DATË 04.02.2014)